REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 208120
Datë/Datum. 07.04.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Shefkinaze Vllasaliu | 30.03.2020 | 06.03.2020 | 208-20 |
|---|---|---|---|
| *Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi* | *Data e autorizimit të ekspertit* | *Data e dorëzimit të raportit* | Nr. i lëndës: |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.03.2020, Operatori Ekonomik: TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A., ka parashtruar ankesë me nr: 208/20, kundër Njoftimit për kontratë dhe dokumentet e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit, të publikuar me datë 27.02.2020, për:

Titulli: SHERBIME TELEFONISE MOBILE

me nr. të prokurimit: 634-20-151-2-2-1 dhe numri i brendshëm: 634-20-002-221

i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I KLINËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e hapur, KONTRATË PUBLIKE KORNIZË – FURNIZIM - *Me Një Operator Ekonomik*, vlera e parashikuar e kontratës: 33,000.00 €.

Në pajtueshmëri me nenin 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

*(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).*

Dispozitat e shkelura të *Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092*, sipas Operatori Ekonomik ankues TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A., lidhur me aktivitetin e prokurimit SHERBIME TELEFONISE MOBILE, me nr. të prokurimit: 634-20-151-2-2-1 dhe numri i brendshëm: 634-20-002-221, nga ana e Autoriteti Kontraktues/KUVENDI KOMUNAL I KLINËS janë si në vijim:

***Është shkelur neni 9.4. i LPP-së (Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushën)),***

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim: *"autoriteti kontraktues kur është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik"*. Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik, për me teper edhe interpretimi i KRPP-se thekson se një autoritet kontraktues publik nuk ka nevojë të procedoj ndonjë procedurë të prokurimit përderisa nje sherbim ofrohet nga nje autoritet tjeter kontraktues publik. Shih citatin e KRPP-se:

Citati:

*36. Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës) që të bëhet e qartë se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevoj për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjeter po ashtu publik?*

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:

Sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojn si në vijim:

*"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja mik janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik".*

Pra neni i lartëcituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoj për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik.
LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre ( ne mes vete) meqë kjo është qeshtje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.
Mirëpo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjë me **përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik** kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tijë ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim " në shtëpi).

Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-es, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 te LPP-së
*KRPP, nuk do te publikoj asnjë lloj Njoftimi (Njoftimi për kontrate, Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës) dhe do te deklaroj aktivitetet, vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore ne rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura me larte apo cila do dispozite tjetër e legjislacionit për prokurim publik.*

LINKU: https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=NewsPub&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCNews&ID=313

PROPOZIMI I TELEKOMIT TË KOSOVËS

Të anulohet Njoftimi për kontratë nga KUVENDI KOMUNAL I KLINËS dhe te fillohet një procedurë e re në përputhje me interpretimin e KRPP_së dhe në kërkesat e nenit 9.4 të LPP-së.
Dmth, bazuar në interpretimin e KRPP_së lidhur me nenin 9.4 të LPP-së, si dhe vendimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së për pretendim e njëjtë ankimor të shqyrtuar në të kaluarën (vendimi nr. 48/20 i datës 11.03.2020 kundër Njoftimit për Kontratë nga Universiteti i Prishtinës, vendimi nr. 470/19 i datës 11.09.2019 kundër Njoftimit për Kontratë nga Komuna Mitrovicë, etj.), KUVENDI KOMUNAL I KLINËS nuk ka nevojë të përdor procedurë të prokurimit, pasi që shërbimet në fjalë ofrohen nga një institucion publik që përdor fonde publike.

Mënyra proceduese e anulimit është: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS duhet te kërkoj nga KRPP ose autorizim që të bëjë anulimin e Njoftimit për kontratë.

**Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim.**

## KRITERET PËR VLERËSIM

*(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).*

***Është shkelur neni 9.4. i LPP-së (Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushën),***

## RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
*(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).*

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

*(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).*

Operatori Ekonomik ankues, TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A. *është palë me interes sipas nenit 4.1.26* nga rezultati i këtij aktivitetit të prokurimit të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, në raport me këtë kontratë që mund të jetë në rrezik të dëmtimit material nga një shkelje e pretenduar.

## VENDIMET E MË PARSHME TË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

*(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).*

Nuk ka pasë.

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

*(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).*

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Operatori Ekonomik Ankues, TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A., të pa kënaqur me publikimin që ka te beje me njoftimin e kontratës dhe me dokumentet e tenderit për aktivitetin e prokurimit, SHERBIME TELEFONISE MOBILE, *me nr. të prokurimit: 634-20-151-2-2-1 dhe numri i brendshëm: 634-20-002-221*, ka parashtrua ankesë, sepse pretendon se Autoriteti Kontraktues këtë publikim të tenderit e ka bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe të gjitha aktet tjera nën ligjore, që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

**Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të Njoftimit për kontratë, dosjes së tenderit dhe rrjedhës së procedurës së publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar sqaron me sa vijon:**

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas Operatori Ekonomik ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë:

***Është shkelur neni 9.4. i LPP-së (Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushën),***

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe

pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar **sqaron me sa vijon:**

**Përgjigje në pretendimin e lartë cekur ( Neni *9.4. i LPP-së (Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushën)***

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se është shkelur neni ***9.4. i LPP-së (Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushën)*** është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Lëndës dhe ecurisë së këtijë tenderi, Autoriteti Kontraktues e ka bërë publikimin e këtij aktiviteti të prokurimit në kundërshtim me Nenin 9 pika 4 të LPP-së, citojmë:

**Neni 9**
**Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur**

1. Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikim in e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues.

4. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

Eksperti shqyrtues, konstaton se Autoriteti Kontraktues, me publikimin e këtijë aktiviteti të prokurimit, ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 9 pika 1 dhe 4 të LPP-së, sepse TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A. është autoritet publik, i cili i përmbush nevojat për këto shërbime në pajtueshmëri me nenin 9 pka 4 të LPP-së.

Lidhur me këtë qështje edhe nga KRPP-ja, te INFORMACIONE / PYETJE TË SHPESHTA, lidhur me këto raste ( pyetja dhe përgjigjja 36) kemi interpretim ligjor si në vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik". Pra neni i lartëcituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoj për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik. LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojne plotesimin e nevojave te tyre ( ne mes vete) meqe kjo eshte qeshtje e autioriteteve publike dhe/ose rregullave tjera. Mirëpo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjënë me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që *rregullon* prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tijë ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim " në shtëpi). Si përfundim pas analizimit të cekur më

lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa pët të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-es, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë qështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 te LPP-së.

Eksperti shqyrtues ka konstatuar se mbështetur në Nenin 9 pika 4 të LPP-së dhe interpretimin ligjor të KRPP-së, Paneli Shqyrtues në OSHP me datë 11.03.2020 ka nxjerrë vendimin 48/20 për rastin e njejtë, me të cilin i ka dhënë të drejtë TELEKOMIT TË KOSOVËS Sh.A për të njejtin pretendim, ia ka aprovuar ankesën, duke ja anuluar Njoftimin për kontratë për të njejtin aktivitet të prokurimit një autoriteti tjeter puplik ( Univerzitetit të Prishtinës), për shkak se nuk e ka respektuar nenin 9.4 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues vie në përfundim se Autoriteti Kontraktues, duhet të veproj në pajtueshmëri me Nenin 9.4 të LPP-së dhe në pajtueshmëri me interpretimin ligjor të KRPP-së. Meqenëse kontrata e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe TELEKOMIT TË KOSOVËS Sh.A. me numër të prokurimit 202-16-102-215, ka përfunduar me 30.03.2020, mbetet që KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, të zhvilloj procedurën në pajtueshmëri me nenin 9.4 të LPP-së dhe interpretimin ligjor të KRPP-së, ashtu si e ka realizuar këtë procedurë Ministria e Administratës Publike.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Operatori Ekonomik: TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A., të pranohet e bazuar, njëherësh propozoj që të bëhet ANULIMI i Njoftimit për Kontratë nga ana e Autoritetit Kontraktues/ KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: „ SHERBIME TELEFONISE MOBILE", me nr. të prokurimit: 634-20-151-2-2-1 dhe numri i brendshëm: 634-20-002-221.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues : - TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A.,